

UDHËZIM
Nr. 16, datë 8.7.2026

PËR DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 23, DATË 9.12.2014, “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE”, I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; si dhe në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pikën 10.8, të pikës 10, “Të tjera”, të udhëzimit nr. 23, datë 9.12.2014, pas kategorisë 41, shtohen kategoritë 42 dhe 43, me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“- *Kategoria 42.* Personi, i cili në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe për sigurimet shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve përkatëse është i pajisur me Certifikatë Mbulimi të Kontributeve, përjashtohet nga pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- *Kategoria 43.* Personi, i cili në bazë të një marrëveshjeje dypalëshe për sigurimet shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve përkatëse është i pajisur me Certifikatë Mbulimi të Kontributeve, por me të drejtë zgjedhjeje, paguan kontribute të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi ose sipas përcaktimeve të marrëveshjes dypalëshe përkatëse.”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

Botuar ne FZ 155/2026

Dale nga shtypi 21.07.2026